



AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

RAPORT MONITORIMI

PËR

**“ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË
MJEDISIT 2023 - 2024”**

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive

Qasja vlerësuese

Gjetjet e raportit

Objektivi 1 - Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

Objektivi 2 - Transparenca me publikun

Objektivi 3 - Menaxhimi i buxhetit dhe financës

Objektivi 4 - Menaxhimi i sektorit të kimikateve

Objektivi 5 - Menaxhimi i sektorit të ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)

Konkluzione dhe rekomandime

Hapa të tjera

LISTA E SHKURTESAVE

MTM - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

AKM - Agjencia Kombëtare e Mjedisit

ARM - Agjencia Rajonale e Mjedisit

AKSHI - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

SBNJ - Sektori i Burimeve Njerëzore

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

MVRI - Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

PI – Plani i Integritetit

RKK – Regjistri Kombëtar i Kimikateve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Angazhimi në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorrupsion ka çuar drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Në vitin 2023, Agjencia Kombëtare e Mjedisit në kuadër të zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015- 2023, si dhe duke u bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020, hartoi dhe miratoi Planin e Integritetit të institucionit, të miratuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nr.195, datë 18.08.2023.

Ky dokument përfaqëson përpjekjen institucionale për të prezantuar dhe vendosur një sistem efektiv të menaxhimit të integritetit për periudhën kohore 2023-2024. PI-ja shërben si instrument efektiv për luftën antikorrupsion në nivelin e institucionit duke identifikuar, vlerësuar dhe adresuar risqet që çënojnë integritetin në proceset kryesore të punës së institucionit.

Në Planin e Integritetit të AKM-së, janë të parashikuara gjithsej 14 masa të karakterit rregullator e operacional, të cilat konsistojnë kryesisht në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, etikës, efektivitetit dhe efikasitetit në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ose sektorët e drejtorive sipas rastit. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2024. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vitin 2023-2024, për statusin e zbatimit të tyre, problematikat e hasura në zbatimin e tyre, përmban të dhëna për veprimtarinë operationale të njërive (drejtorive dhe sektorëve) të brendshme kontribuuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, burimeve njerëzore, menaxhimit të financës dhe buxhetit, si dhe transparencës. Për vitin 2023, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 14 masa/aktivitete, të shpërndara në pesë objektiva, përkatësisht:

Objektivi 1 - Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

Objektivi 2 - Transparenca me publikun

Objektivi 3 - Menaxhimi i buxhetit dhe financës

Objektivi 4 - Menaxhimi i sektorit të kimikateve

Objektivi 5 - Menaxhimi i sektorit të ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)

Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 14 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për periudhën 2023-2024/në vijimësi, rezulton se: është zbatuar 1 masë/aktivitet, afati së cilës ishte 6 mujori i dytë i vitit 2023.

Janë zbatuar 11 masa/aktivitete dhe vijohet me zbatimin e tyre pasi janë procedura të vijueshme të punës, dhe 2 masa/aktivitete kanë afat zbatimi në vijimësi.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të drejtorive dhe sektorëve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Raporti përmban një analizë cilësore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre.

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori për zbatimin e Planit të Integritetit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit.

Koordinatori për zbatimin e Planit të Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme. Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njëjësive përgjegjëse në këtë raport, të cilët janë ngritur me urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr.275, datë 12.12.2023, për raportimin sipas objektivave:

Objektivi 1 - Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse;

Objektivi 2 - Transparenca me publikun;

Objektivi 3 - Menaxhimi i buxhetit dhe financës;

Objektivi 4 - Menaxhimi i sektorit të kimikateve;

Objektivi 5 - Menaxhimi i sektorit të ankimimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve)

Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të zbatuar dhe për zbatim; akte dhe dokumenta të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; të dhëna për buxhetin; rekomandime dhe konkluzione. Raporti është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Objektivi 1 - Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

Përmes këtij objektivi synohet të adresohen risqet që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin profesional të tyre, të cilat vështirësojnë përpjekjet e institucionit të realizojë proceset e punës me cilësi dhe ofrimin e shërbimeve me standarde.

Ky objektivi përmban një numër prej 6 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësi e përfshirë.

Masat e parashikuara në këtë objektivi, nga monitorimi rezulton se: 1 masë është zbatuar plotësisht, 5 zbatohen në vijueshmëri.

Objektivi 2 - Transparenca me publikun

Përmes këtij objektivi synohet të adresohen risqet që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Duke marrë në konsideratë se Programi i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përfaqësojnë instrumente efektive për transparencë publike të veprimtarisë së institucionit, plani i masave synon rritjen e transparencës përmes plotësimit të tyre dhe publikimin e çdo informacioni të nevojshëm për publikun në fushën e përgjegjësisë së institucionit. Ky objektivi përmban 1 masë për t'u zbatuar e cila është me afat zbatimi në vijimësi.

Gjatë kësaj periudhe, IT i AKM-së sipas informacioneve dhe të dhënave të përcjella nga Drejtoritë e AKM-së dhe Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka përditësuar informacionet që duhet të publikohen në faqen zyrtare të AKM-së.

Objektivi 3 - Menaxhimi i buxhetit dhe financës

Përmes këtij objektivi synohet të adresohen risqet që lidhen me menaxhimin e buxhetit dhe financës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të cilat vështirësojnë përpjekjet e institucionit të realizojë proceset e punës me cilësi dhe ofrimin e shërbimeve me standarde.

Ky objektivi përmban një numër prej 4 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësia e përfshirë.

Masat e parashikuara në këtë objektivi, nga monitorimi rezulton se: 3 masa zbatohen në vijueshmëri dhe për 1 masë, sektori vijon punën për realizimin e saj, duke qenë se afati i zbatimit është në vijimësi.

Objektivi 4 - Menaxhimi i sektorit të kimikateve

Përmes këtij objektivi synohet të adresohet risku që lidhet me krijimin dhe mbarëvajtjen e Regjistrimit Kombëtar të Kimikateve.

Ky objektivi përmban 1 masë specifike për t'u realizuar e cila e ka afatin e zbatimit në vijimësi. Sa i përket kësaj mase, sektori i kimikateve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit ka marrë pjesë në takime pune me qëllim realizimin e Regjistrimit Kombëtar të Kimikateve. Në datën 20 shtator është zhvilluar në MTM një takim me përfaqësues të projektit mbështetës Suedez (KEMI), për krijimin e RKK. Gjithashtu, në kuadër të krijimit të databazës për RKK është miratuar një grup pune me përfaqësues nga Sektori i Kimikateve në AKM dhe nga MTM, për të bashkëpunuar me AKSHI-n deri në finalizimin e RKK.

Objektivi 5 - Menaxhimi i sektorit të ankimimeve (apelim, ekzekutim dhe trajtim i penaliteteve)

Përmes këtij objektivi synohet të adresohen risqet që lidhen me menaxhimin dhe ekzekutimin e masave administrative ndaj subjekteve të sanksionuara. Ky objektivi përmban 2 masa specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësia e përfshirë.

Masat e parashikuara në këtë objektiv, nga monitorimi rezulton se: 2 masa janë me afat zbatimi në vijimësi dhe sektori vijon zbatimin e tyre me qëllim bashkërendimin sa më të mirë të punës.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të Planit të Integritetit në institucionet qëndrore, dhe të hartimit të raportit të monitorimit. Ky vit, viti 2023 është viti i parë i zbatimit të këtij plani integriteti në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën Gusht – Dhjetor 2023, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave që drejtoritë dhe sektorët kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se: Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit.

Njësitë (drejtoritë dhe sektorët) e Agjencisë, kanë shënuar përparime kryesisht në forcimin e kapaciteteve të stafit, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, menaxhimin e financës dhe buxhetit të institucionit, transparencës me publikun mbi fushën e përgjegjësisë dhe funksionet e AKM-së, si dhe në hartimin e paketës së plotë të kuadrit të etikës, integritetit dhe të instrumenteve e mekanizmave rregullatore antikorrupsion.

Hapa të tjera

Të vijohet me zbatimin e parashikimeve në planin e veprimit; - Të vijohet me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, të vijohet me menaxhimin e financës dhe buxhetit të institucionit si dhe me funksionimin e faqes zyrtare të internetit të AKM-së për informimin e publikut. Gjithashtu, të vijohet me punën për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Kimikateve, menaxhimin dhe bashkërendimin e punës për ekzekutimin e masave administrative.